

Mësoni më shumë rreth projektit në:
www.cred4teach.eu

QERSHOR 2024

Buletin Vol. 1



Çfarë është CRED4TEACH?


CRED4TEACH është akronimi i projektit Erasmus+ “Mikrokredenciale të bazuara në MOOC për zhvillimin profesional të mësuesve”. CRED4TEACH i përgjigjet nevojave të institucioneve të arsimit të lartë dhe vendimmarrësve në fushën e arsimit në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë, për të ofruar trajnime me cilësi të lartë, gjithëpërfshirëse,

fleksibël dhe të bazuara në kompetenca për mësuesit në të gjitha nivelet e arsimit. Duke patur këtë parasysh, projekti synon të krijojë mikrokredenciale të bazuara në MOOC për të shtuar mundësitë e zhvillimit profesional të mësuesve në vendet e synuara.

Objektivat e CRED4TEACH:

- Të përmirësojë aftësitë e stafit për hartimin dhe ofrimin e mikrokredencialeve të bazuara në MOOC;
- Të zhvillojë dhe të prezantojë kornizat kombëtare dhe institucionale për ofrimin, lëshimin dhe njohjen e mikrokredencialeve;
- Të krijojë, ofrojë dhe të vlerësojë mikrokredenciale pilot të bazuara në MOOC;
- Të inkurajojë një zbatim më të gjerë të mikrokredencialeve në zhvillimin profesional të mësuesve dhe grupeve të tjera të synuara.

Rezultatet konkrete të CRED4TEACH:



Çfarë është qasja inovative CRED4TEACH?

Qasja inovative CRED4TEACH është të kombinojë elemente të edukimit formal (mikro-kredenciale) dhe joformal (strategji pedagogjike të bazuara në MOOC) për të modernizuar zhvillimin profesional të mësuesve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë.

Mikro-kredencialet janë kurse ose **programe** të shkurtra dhe fleksibël **mësimi formal**, që mundësojnë përvetësimin e synuar të aftësive e kompetencave. Gjithashtu, mikro-kredencialet ruajnë të dhëna mbi rezultatet e arritura të mëimit, të bazuara në standarde të përcaktuara qartë.

Çfarë janë Mikro-kredencialet?

Mikro-kredenciale të bazuara në MOOC

Projekti ka filluar më 1 qershor 2023. Me këtë buletin, ne festojmë arritjet e vitit të parë të projektit dhe do të dëshironim t'ju paraqesim disa të dhëna interesante rreth punës sonë.

Mund ta ndani këtë buletin me kolegët dhe në rrjetet e juaja, duke na ndihmuar të modernizojmë zhvillimin profesional të mësuesve!



Çfarë është MOOC-u?

MOOC-et (Kurse Massive të Hapura Online) janë kurse online që janë të mundura për këdo që dëshiron të regjistrohet. Ato janë hartuar për një numër të madh pjesëmarrësish, duke aplikuar një teknologji hartimi mësimor specifik që mundëson fleksibilitet në kohë dhe hapësirë, ndëveprim me nxënësin dhe **mësim joformal** e të pavarur.

Trajnim DREJT AFTËSIMIT SI HARTUES MOOC-u

- ✓ Data e fillimit: 13 nëntor 2023
- ✓ Data e mbarimit: 2 shkurt 2024
- ✓ Ngarkesa e punës: 12 javë (90 orë)
- ✓ Formati: trajnim i përzier
- ✓ Rezultati: 48 hartues të kualifikuar të MOOC-eve

Kursi i kombinuar 12-javor i ofruar nga partneri i CRED4TEACH, Universiteti Anadolu (Turqi), ka pajisur 48 anëtarë të ekipit nga tetë universitete në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të hartuar MOOC-e të një cilësie të lartë dhe për të përdorur strategjitë pedagogjike të bazuara në MOOC në mënyrë sa më efektive.


Faza e parë e kursit u realizua si një kurs online asinkron, duke i dhënë mundësinë pjesëmarrësve të mësojnë si nga përmbajtja e tij, ashtu edhe nga mënyra e dorëzimit të kursit. Seanca pasuese 3-ditore u mbajt në Universitetin Anadolu nga data 10 deri më 12 janar 2024, duke bashkuar pjesëmarrësit e kursit në Eskisehir për të ndarë ide, udhëzime të detajuara dhe për të ndërtuar skicën e



projekteve të MOOC-eve që do të paraqiteshin si detyrë përfundimtare për vlerësim në kurs. Gjatë prezantimit final online të projekteve të MOOC-eve më 2 shkurt 2024, pjesëmarrësit paraqitën dhe diskutuan projekt-kurset e tyre të para, duke nxjerrë në pah aftësitë e tyre në këtë fushë.



Certifikatë Përfundimi e merituar iu dha 48 hartuesve të rinj të MOOC-eve nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Ukraina. Urime për këtë sukses!



Trajnimi KORNIZA TEORIKE DHE AKREDITIMI I MIKRO-KREDENCIALEVE

- ✓ **Data e fillimit:** 5 shkurt 2024
- ✓ **Data e përfundimit:** 7 shkurt 2024
- ✓ **Ngarkesa e punës:** 20 orë
- ✓ **Formati:** trajnim ballë për ballë
- ✓ **Rezultati:** 22 projektues të kualifikuar të mikro-kredencialeve

Trajnimi u organizua nga partneri i CRED4TEACH, Universidade Aberta në Lisbonë, dhe synonte pajisjen e vendimmarrësve të rëndësishëm nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Ukraina me qasje për ofrimin dhe akreditimin e mikro-kredencialeve.

Gjatë tre ditëve të trajnimit, pjesëmarrësit u përkushtuan në hartimin e strategjive dhe dispozitave për zhvillimin profesional të mësuesve dhe rolin e mikro-kredencialeve në këtë proces.

Pjesëmarrësit shqyrtuan bazën ligjore dhe rregullatore për njohjen e mikro-kredencialeve në Bashkimin Evropian, analizuan kushtet paraprake dhe sfidat e menjëhershme për zbatimin praktik të mikro-kredencialeve në Ukrainë, Shqipëri dhe Malin e Zi, si dhe ranë dakord për një plan veprimi, duke u bazuar edhe në rregulloret kombëtare ekzistuese të vendeve të tyre.



Gjithashtu, pjesëmarrësit u njohën me qasjet e ofrimit të MOOC-ve në Universidade Aberta, fondin e burimeve dhe studion mediatike.

Përfundimi i trajnimit shënoi arritjen e një faze të rëndësishme të projektit, duke u hapur rrugë pjesëmarrësve të kualifikuar të trajnimit të projektojnë mikro-kredenciale të bazuara në MOOC.



Takimet e partnerëve të CRED4TEACH

Takimi i fillimit të projektit

Nga 16 deri më 17 tetor 2023, u mbajt takimi i fillimit të projektit CRED4TEACH në Fachhochschule des Mittelstandes (FHM) në Këln, Gjermani. Në këtë takim u mblodhën 20 pjesëmarrës fizikë dhe 19 virtualë nga shtatë shtete partnere: Shqipëria, Estonia, Gjermania, Mali i Zi, Portugalia, Turqia dhe Ukraina, përfaqësues të 15 institucioneve partnere. Pjesëmarrësit kaluan 1.5 ditë interesante duke njohur e mësuar për njëri-tjetrin, duke diskutuar, planifikuar, marrë vendime dhe eksploruar pikat turistike më të famshme e kulinarinë e Këlnit. Ishte shumë emocionuese të fillonim një aventurë 36-mujore, ku do krijonim programe të reja trajnimi të shkurtra të bazuara në MOOC për zhvillimin profesional të mësuesve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë.



Takimi i dytë transnacional i projektit

Nga 25 deri më 26 prill 2024, takimi i dytë transnacional i projektit u organizua nga Universiteti Mesdhetar në Podgoricë, Mal i Zi. Tema kryesore e takimit ishte diskutimi i kornizave kombëtare të mikro-kredencialeve të paraqitura nga Agjencitë Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në Shqipëri, Mal i Zi dhe Ukrainë, dhe hapat e mëtejshëm për implementimin e tyre në shtetet e synuara. Për t'u dhënë gjallëri diskutimeve dhe për të nxitur ndërveprimin, e pasuruam takimin me workshop dhe punë grupi, duke bashkuar pjesëmarrësit nga vende të ndryshme. Kjo na ndihmoi të kuptojmë më mirë nevojat e veçanta të njëri-tjetrit dhe t'i harmonizojme ato me qasjen e projektit. Takimet sociale shoqëruar me peizazhet natyrore të Podgoricës në sfond krijuan kujtime të bukura dhe forcuan lidhjet tona!





Pikat kryesore nga partnerët CRED4TEACH Mal i Zi

Duke qenë se bashkëpunimi mes partnerëve në nivel kombëtar është i rëndësishëm për realizimin me sukses të projektit, një takim pune u mbajt më 8 maj 2024, në Nikshiq, në Fakultetin e Filozofisë (Universiteti i Malit të Zi). Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohej harmonizimi i kornizave kombëtare dhe institucionale të mikro-kredencialeve. Të gjithë partnerët malazezë (Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Mesdheut dhe Agjencia për Kontrollin dhe Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë) ranë dakord për dinamikën e realizimit të qëllimeve të projektit dhe hartuan aktivitetet e ardhshme për projektimin dhe zbatimin e mikro-kredencialeve.



SHQIPËRI

Universiteti i Shkodrës, së bashku me Zyrën Kombëtare të Erasmus+, mori pjesë në aktivitetin e parë të Javës Evropiane 2024. Ky aktivitet u realizua në qytetin e Shkodrës, në Shirokë, më 4 maj 2024. Në stendën dedikuar Universitetit të Shkodrës, u prezantua projekti CRED4TEACH, së bashku me projekte, programe, rezultate të tjera dhe botime të ndryshme të realizuara nga grupet e punës dhe ato kërkimore të Universitetit të Shkodrës të mbështetura nga Bashkimi Evropian. Stendën e vizitoi gjithashtu Ambasadori Z. Silvio Gonzato dhe shumë vizitorë të tjerë të interesuar për qasjet inovative dhe rezultatet e paraqitura.



UKRAINË

Forumi Shkencor Ndërkombëtar VI, i titulluar “Krijimi i një hapsire informacioni të unifikuar dhe të hapur për të mësuarit gjatë gjithë jetës”, u mbajt në Akademinë e Pedagogjikës Inxhinierike të Ukrainës nga data 26 deri më 29 mars 2024. Numri i pjesëmarrësve të regjistruar në forum e kalonte 370

persona nga Ukraina dhe nga vende të ndryshme të huaja, përfshirë shkencëtarë dhe specialistë nga më shumë se 70 vende. Programi i forumit përfshinte një prezantim të projektit CRED4TEACH në formën e një tryeze të rrumbullakët, që mbledhi së bashku mësues nga sektorë të ndryshëm.



Çfarë pritet në vijim?

Kornizat kombëtare për zbatimin e mikro-kredencialeve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë parashikohet të përfundojnë në fund të qershorit 2024. Bazuar në këto korniza kombëtare, universitetet partnere nga këto vende do të krijojnë dhe miratojnë rregullore të brendshme për ofrimin e mikro-kredencialeve.

Infrastruktura teknologjike për ofrimin dhe lëshimin e mikro-kredencialeve të bazuara në MOOC do të vendoset në universitetet partnere, duke u mundësuar atyre të veprojnë si ofrues të mikro-kredencialeve me cilësi të lartë.

Hartuesit e kualifikuar të MOOC-ve dhe mikro-kredencialeve do të punojnë së bashku në përgatitjen e mikro-kredencialeve pilot të bazuara në MOOC.

MBANI MEND DATËN!

Më 10 tetor 2024, do të mbahet konferenca e parë transnacionale e projektit në Universitetin e Vlorës në Shqipëri. Ne do të ndajmë rezultatet e para të projektit me komunitetin akademik të vendeve të Ballkanit. Ndiqni njoftimet tona në rrjetet sociale dhe mos e humbisni mundësinë për t'u bërë pjesë e këtij eventi.

Vazhdoni të na ndiqni!

Shikoni faqen tonë të internetit:
www.cred4teach.eu

Na ndiqni:
Për të mësuar më shumë rreth projektit në:



Programi:
Erasmus+, Key Action 2 -
Ndërtimi i Kapaciteteve
në Arsimin e Lartë

Kohëzgjatja e projektit:
1 qershor 2023 – 31 maj 2026

Koordinator i projektit:
Fachhochschule des
Mittelstands (FHM)

